



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Nasuf Shabani f.sh.Mikushnicë, 41000 Skenderaj, Republika e Kosovës

E PADITUR: REPUBLIKA E SERBISË –Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës
nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMI

Propozim për lirimin nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit

Vlera e kontestit : 1180700 €

1). Për tju shmangur rrezikut nga forcat ushtarako-policore serbe paditësi me 7 anëtar te familjes është detyruar ta braktise shtëpinë qe nga data 22.09.1998 deri me datën 12.10.1999, respektivisht 1 vit e 20 dite duke qëndruar tek te afërmit kryesisht neper Drenice, ndërsa një kohe edhe ne Mitrovice ne rrugën “Enver Haliti” nr.1 por nuk i kujtohet emri i pronarit te shtëpisë. Gjate qëndrimit ne Mitrovice paditësit i zihen dhe i arrestohen dy djem nga ana e forcave serbe, Naim dhe Sefer Shabani te cilët mbahen ne burg gjate një kohe e pastaj i dëbohen ne Republikën e Shqipërisë ku qëndrojnë nga data 14.04. deri me 15.07.1999.

2). Paditësi ka qen i larguar nga vendi i punës sekretar i shkollës te mesme te mjekësisë “Desa Tomasheviq” në Mitrovicë nga data 24.4.1991 si pasoje e vendimit politik e duke u thirrur ne pretekstin gjëja se nuk e ka realizuar Planin dhe Programin arsimor ne përputhshmëri me Ligjin e RSS mbi arsimimin gz.nr.48/90, kurse me datën 11.03.1955 arrestohet nga ana e policisë serbe ne Mitrovice ne rrugën “Crnjanskog” pn. Per shkak te organizimit te provimeve private ne shkollën e mesme te mjekësisë “Gjeladin Deda”, me q’rast i shqiptohet dënimi me burg nga ana e Gjykatës Komunale per Kundervajtje ne Mitrovice ne kohëzgjatje prej 20 dhe e vuan dënimin .

Provë: - Vendimi mbi ndërprerjen e mardhenjës së punës nga pozita e sekretarit te shkollës së mesme te mjekësisë “Desa Tomoviq” ne Mitrovicë, nr118-162 /5 i datës 26.08.1991

- Vendimi i Gjykatës për Kundervajtje ne Mitrovicë Up.I.br.533/95 i datës 13.03.1995

3.) Padiësi me anëtarët e familjës është pronar i sendeve të luajshme dhe të pa luajshme të cilat janë krijuar nga puna e përbashkët dhe trashëgimia, kjo patundshmëri përbehet prej shtëpisë me sipërfaqe prej 489 m², dëmtim të kategorisë së V, me interier shtëpiak duke e përfshirë tekniken e bardhe në sallën dhe mobilierinë e dhomave të gjumit, pastaj i është djegur stalla e bagëtisë, mulliri shtëpiak, garazha, shupa, 2 hamare me drithi, plemes për ushqim të bagëtisë si dhe i janë plaçkitur bagëtia nga 2 krerë lop dhe 2 vjeta i është plaçkitur traktori me pajisjet përcjellëse, i është vërtetuar qeni shtëpiak dhe i kanë humbur shpezët 90 copë pula .

Provë : - Kërkesa për kompensimin e dëmeve të luftës , e dt.24.12.2008, nr. 580 - 9

- Vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit nr.325-521 i datës 12.12.2008.

dt.18.12.2008 dhe foto e shtëpisë së djegur

- Deklarata familjare sipas nr.rendor 20487 e dt.30.12.2008

- 4 kopje të planit në emër të: Sefer Vesel Shabanit, Emin Demir Shabanit dhe Imer Asllan Behramit nga fsh.Mikushnice, Muharrem Rrahman Shabanit nga fsh.Beqiq si dhe Fleta poseduese nr.60 në emër të Sefer Vesel Shabanit nga fshati Mikushnic

- Dëgjimi i padiësit dhe dëshmitarëve të propozuar, provave të lartcekura si dhe provave të tjera të cilat padiësi do të prezantojë në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në rast nevojë të caktohet edhe eksperti përkatës

4.) Të drejtën për kompensim padiësi e bazon në nenin 185 të LMD (G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78) në lidhje me nenin 180.1 të të njëjtit Ligj , me të cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë të personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura, ka qenë e obliguar të pengojë aktet e vrasjes , dhunës, terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes së pasurisë së padiësit. .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (neni 1 Protokollin nr. 1 , neni 2 dhe protokollin nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Padiësi propozon që kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor të çështjes , t'i shfrytëzojë informatat e dhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bëjë këtë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesa e padiësit Nasuf Shabanit të lindur me datën 07.05.1950 në fshatin Mikushnicë , 41000 Skenderajt Republika e Kosovës në tërësi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Republika e Serbisë, respektivisht Qeveria si pasardhëse juridike e Qeverisë së mëparshme që në emër të të njëjtës të kompensojë demin material dhe jo material padiësit Nasuf Shabanit me vendbanim në f.sh.Mikushnicë , 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumën prej 38 400 € në emër të pagës për 96 muaj
- shumën prej 210 000 € për torturë dhe shantazhim gjatë qëndrimit në burg
- shumën prej 76800 € për dhembjen shpirtërore dhe të munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banuarit nënë qiell të hapur dhe shtëpi të huaja
- shumën prej 60 000 € për shkak të pamundësuarit e krenimit të festave fetare në shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes së kontaktit me familjen dhe të afërmit
- shumën prej 733500 € për shtëpinë e djegur – shkatërruar

- shumën prej 45000 € për shtallën e djegur, shupën, 2 hamarve më grur, mullirit shtepiak dhe plemen
- shumën prej 17 000 € traktorin e marrurr me pajisjet tjera.
- shumën prej _____ € për pamundësimin e shfrytëzimit të tokës bujqësore për tri vite.

te gjitha këto shuma me kamat ligjore që nga dita e ngritjes së padisë e deri në ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm .

Pala e paditur të paguaj shpenzimet procedurale të kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm .

1.) të bihet :


AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit të paditëses në ter çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysh gjendjen e vështir ekonomike të paditëses në kuptim me nenin të Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 të Ligji Nr. 03/L-006 .

Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi

Nasuf Shabani .



Shtojcë :

- 1.Kërkesa për kompensimin e dëmeve të luftës , e dt. 24.12. nr. 580 – 9
- 2.vendimi mbi nderprerjen e mardhenjës së punës nga pozita e sekretarit të shkollës së mesme të mjeksisë “Desa Tomoviq”ne Mitrovicë,nr118-162 /5 i datës 26.08.1991
- 3.Vendimi i Gjykatës për Kundervajtje në Mitrovicë Up.I.br.533/95 i datës 13.03.1995
4. Vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit nr325-521 i datës12.12.2008. dt.18.12.2008
5. Kopjet e planit me fletet poseduese si dhe deklarata e deshmitarëve
6. 4 kopje të padisë